

“RREGULLORE E BRENDSHME

“Enkeleda Stefani” PF

PER

PARANDALIMIN E PASTRIMIT TE PARAVE DHE FINANCIMIN E TERRORIZMIT”

Ne mbeshtetje te ligjit nr. 9917 dt 19/05/2008 “Per parandalimin e pastrimit te parave “, (ndryshuar me ligjin nr.10 391, datë 3.3.2011; nr. 66/2012, datë 7.6.2012; nr. 44/2017, datë 6.4.2017; nr. 33/2019, datë 17.6.2019, nr. 120/2021, datë 2.12.2021; nr. 62/2023, datë 21.7.2023), Per te parandaluar pastrimin e parave si dhe per te luftuar financimin e terrorizmit perpilojme kete rregullore per ndjekjen e problemeve te parandalimit te pastrimit te parave si dhe parandalimit te financimit te terrorizmit”.

Bazuar ne nenin 11 te ketij ligji pika (b) :

- Emerohet person pergjegjes zj. Enkeleda Stefani

Bazuar ne nenin 11 pika (c) duhet :

- Të mbahet dhe perditohet sistemi i centralizuar pergjegjës për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave.

Identifikimi i klienteve

Kerkohet dhe te mbahet nje informacion i plote dhe i mjaftueshem ne lidhje me identifikimin e klientit nepermjet mjeteve te identifikimit dhe burimin e te ardhurave te klientit, mbasi moskryerja e ketyre veprimeve, konsiderohen si veprime qe ndihmojne transaksionet e aktiviteteteve te dyshimta.

Vigjilenca e thjeshtuar

- Ushtrohet ndaj klientëve për të cilët identifikohet një rrezik i ulët bazuar në vlerësimet e riskut të autoriteve si dhe të vetë subjektit;
- Në rast se gjatë kryerjes së monitorimit të vazhdueshëm vlerësohet apo ka element për të besuar se nuk është më i ulët rreziku i PP/FT subjektet janë të detyruara të marrin masat e plota për zbatimin e vigjilencës së duhur;

- Vigjilenca e thjeshtuar nuk mund të zbatohet në rastet kur ka dyshime për pastrim parash, financim të terrorizmit apo vepra penale që krijojnë produkte të veprës penale, si dhe kur zbatohet vigjilenca e zgjeruar apo skenare specifike të riskut të lartë;
- Ndalohet kryerja e vigjilencës së thjeshtuar ndaj kategorive të klienteve kur kjo vendoset nga autoriteti përgjegjës;

Vigjilenca e duhur

Para vendosjes së një marrëdhënie biznesi subjektet duhet të:

- Të identifikojnë klientin;
- Të identifikojnë pronarin përfitues ;
- Të kuptojnë strukturën e pronësisë dhe kontrollit;
- Të përcaktojnë nëse klientët janë duke vepruar në emër të një personi tjetër, dhe të marrin masa për ta identifikuar atë person.
- Të përcaktojnë profilin e riskut të klientit;
- Të sigurojnë një vlerësim të vazhdueshëm të marrëdhënies;

Vigjilenca e zgjeruar

Për zbatimin e vigjilencës së zgjeruar ndaj klientëve, subjektet mund të kërkojnë praninë fizike të klientëve dhe të përfaqësuesve të tyre para se të vendosin një marrëdhënie biznesi

Gjithashtu përfshin masa shtesë, për klientët apo transaksionet që konsiderohen me risk të lartë.

Klientë:

- PEP;
- Klientët jo-rezidentë;
- Trustet dhe organizimet ligjore;
- OJF;

Transaksione:

- komplekse, me vlera të larta dhe të pazakonta, të cilat nuk kanë qëllim të dukshëm ekonomik ose ligjor

- kufizojnë marrëdhëniet e biznesit ose transaksionet me individët apo persona juridikë nga vendet me risk të lartë

Raportimi i transaksioneve te parase Fizike RTPF

Subjekteve u kërkohet t'i raportojnë autoritetit përgjegjës, sipas afateve të përcaktuara në aktet nënligjore, në zbatim të këtij ligji, për të gjitha transaksionet në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 000 000 (një milion) lekë ose kundërvlerën në monedha të huaja, të kryera si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njëra-tjetrën brenda 24 orëve.

Raportimi i transaksioneve te dyshimta

Ne qofte se gjate ushtrimit te aktivitetit te do te vihen re raste te klienteve per te cilet do te dyshojme se te ardhurat e tyre nuk justifikohen me aktivitetin qe kryhen ose nese do te verehen anomali, personi pergjegjes, duhet ti raportoje ato si raste te aktivitetit te dyshimte, nepermjet formulareve RAD. Raportimi bëhet menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë.

Personat pergjegjes duhet te informohen ne menyre te vazhdueshme mbi legjislacionin ne faqen zyrtare te autoritetit pergjegjes .

Per “Enkeleda Stefani ” PF

Pergjegjes:

Enkeleda Stefani